



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**

I. Cili institucion është përgjegjës për Administrimin e Regjistrimit të Kredive

Banka e shqipërisë mban dhe administron Regjistrin e Kredive me qëllim trajtimin e centralizuar dhe shpërndarjen e informacionit të regjistruar në të, në funksion të ushtrimit të procesit të mbikëqyrjes dhe administrimit optimal të rrezikut të kredisë nga subjektet e mbikëqyrura prej saj.

Krijimi i Regjistrimit të Kredisë si dhe kompetencat e Bankës së Shqipërisë lidhur me të, sanksionohen me nenin 127 të ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

II. Kush është përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar në Regjistrin e kredive

Raportuesit e të dhënave janë përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar pranë këtij sistemi dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim.

III. Si mund të informohen lidhur me të dhënat që bankat dhe institucionet e tjera financiare kanë raportuar për mua në Regjistrin e kredisë

Për tu njohur me të dhënat që janë raportuar për Ju në Regjistrin e kredive, Ju duhet të bëni kërkesën pranë Bankës së Shqipërisë si dhe të plotësoni dokumentacionin e nevojshëm, për tu pajisur me Raportin Zyrtar të Kredimarrësit.

Dokumentacioni mund të dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë, në zyrat qendrore të saj në Tiranë. Për kërkesat nga rrethet, dokumentacioni i nevojshëm mund të depozitohet dhe pranë degëve të Bankës së Shqipërisë në rrethet :Shkodër, Elbasan;Gjirokastër;Korcë dhe Lushnje.

IV. Ku duhet të drejtohem në rast se kam pretendime mbi të dhënat që pasqyrohen në Raportin Zyrtar të Kredimarrësit

Mbas tërheqjes së raportit Zyrtar të Kredimarrësit, në cdo rast do të keni pretendime mbi të dhënat e pasqyrura në të, mjafton të paraqiteni pranë zyrave të Bankës Qendrore/ose në degët e saj, për të plotësuar formularin e kërkesës për rishikimin e të dhënave. Punonjësi i autorizuar fillon trajtimin e kërkesës duke kontaktuar menjëherë raportuesin e të dhënave, duke i kërkuar verifikimin e të dhënave/informacionit të cilat pretendohen se janë të pasakta dhe/ose të paplota.

Nëse nga verifikimi i kryer konstatohet se të dhënat/informacioni i raportuar është i pasaktë ose i paplotë, raportuesi i të dhënave duhet menjëherë t'i korrigjojë ato dhe të bëjë përditësimet e nevojshme në Regjistrin e kredisë.

Nëse pas verifikimit të kryer nga raportuesi i të dhënave, rezulton se informacioni i cili kërkohet të rishikohet është i saktë, atëherë informacioni i Raportit për Kredimarrësin nuk ndryshon.

V. Cfarë Informacioni raportohet në Regjistrin e Kredisë

Në regjistrin e kredive raportohen të dhëna mbi identitetin e kredimarrësve, personave të lidhur me ta, të dhëna mbi ekspozimet e tyre në sistemin bankar e financiar.

Kategoritë e ekspozimeve që raportohen pranë këtij sistemi janë :

1. Kreditë
2. Kartat e Kreditit
3. Overdraftet
4. Letër kreditë –Të financuar me fondet e Raportuesit të të dhënave
5. Letër Garancitë – Të financuar me fondet e Raportuesit të të dhënave
6. Qeratë financiare

Në regjistrin e kredive raportohen gjithashtu, në rastet kur është e aplikueshme dhe të dhëna lidhur me pasuritë (të luajtshme/të paliajtshme) të lëna si garanci.

VI. Në çfarë frekuence raportohen dhe përditësohen të dhënat pranë Regjistrin të Kredive

Raportuesit e të dhënave, raportojnë brenda ditës së nesërme të punës:

- ✓ çdo kredi të re, kredi të paguar dhe kredi të fshirë nga bilanci; si dhe
- ✓ çdo "Letër Kredi" ose "Letër Garanci" të miratuar dhe të financuar me fondet e raportuesit të të dhënave.

Raportuesit e të dhënave raportojnë në Regjistrin e Kredive, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të para të punës të muajit pasardhës, përditësimin e të dhënave të kredimarrësit, si dhe gjendjen e portofolit të kredive bashkë me klasifikimet përkatëse.

VII. Sa kohë qëndrojnë të dhënat në Regjistrin e Kredive /Kur fshihen të dhënat dhe informacioni Negative

Informacioni dhe të dhënat në Regjistrin e kredive qëndrojnë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së kredisë si dhe për 5 vite të tjera, nga data në të cilën kredia është raportuar si "kredi e paguar-statusi 5" ose e "fshirë nga bilanci- statusi 6.

Informacioni dhe të dhënat negative, fshihen nga regjistri i kredive, pas përfundimit të afatit të lartpërmendur.